



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 236/2 Prot.

Tiranë, më 16.03.2018

VENDIM

Nr.13, datë 16/03/2018

PËR

**MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË BASHKINË PRRENJAS DHE
PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E
LIGJSHMËRISË.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Prrenjas,

KONSTATOVA SE:

Me vendimin nr. 211, datë 25.10.2017, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Librazhd dhe në Bashkinë Prrenjas”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në institucionin Bashkia Prrenjas.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 1722 prot., datë 25.10.2017, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr.1722/1 prot., datë 25.10.2017, “*Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes*”, i është njoftuar Bashkisë Prrenjas.

Bashkia, si organ i vetëqeverisjes vendore, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 8549/1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, (i shfuqizuar) dhe ka ruajtur të njëjtin status edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, pasi, në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 236, datë 06.02.2018, “*Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Bashkinë Prrenjas, në lidhje me administrimin e shërbimit civil*”, duke i lënë një afat 15 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me përmbajtjen e materialit, nëpërmjet shkresës nr. 236/1 prot., datë 20.02.2018, të Kryetarit të Bashkisë Prrenjas, “*Dërgohet projektraporti për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil pranë Bashkisë Prrenjas dhe observacionet përkatëse*”, ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, bashkëlidhur edhe observacionin, duke u shprehur dakord në lidhje me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i mbikëqyrjes, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “*Procedura hetimore*”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të miratojë përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Prrenjas, dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë:
2. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në Bashkinë Prrenjas, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr.116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duhet të finalizojë procesin e deklarimit të statusit të punësimit, duke nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, si “Nëpunës civil”, sipas procedurave specifike të përcaktuara në ligj, për punonjësit si më poshtë:
 1. *****, punësuar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Pyjor dhe Mjedisor”, në Bashkinë Prrenjas, emëruar me aktin nr. 47, datë 03.10.2011;
 2. *****, punësuar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Informimit për publikun dhe marrëdhëniet e shanseve të barabarta dhe barazisë gjinore”, në Bashkinë Prrenjas me aktin nr. 48, datë 03.10.2011.
 3. *****, punësuar në pozicionin “Arkiv-sekretari”, në Bashkinë Prrenjas, emëruar me aktin nr. 48/1, datë 16.06.2002;
 4. *****, punësuar në pozicionin “Inspektor i arsimit dhe kulturës”, në Zyrën e Arsimit, Kulturës dhe Sporteve, në Bashkinë Prrenjas, emëruar me aktin nr. 46, datë 08.09.2008;
 5. *****, punësuar në pozicionin “Përgjegjës i Auditit të Brendshëm”, në Bashkinë Prrenjas, me aktin nr. 42, datë 01.09.2011;
 6. *****, punësuar në pozicionin “Inspektor emergjencash”, në Zyrën e Ndihmës Ekonomike, në Bashkinë Prrenjas, me aktin nr. 35, datë 22.08.2011;
 7. *****, punësuar në pozicionin “Veteriner”, në Zyrën e Veterinarisë, në Bashkinë Prrenjas (Mungon akti i emërimit, sipas librezës së punës marrëdhëniet financiare kanë filluar në datën 11.09.1998);
 8. *****, punësuar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave”, në Bashkinë Prrenjas (Mungon akti i emërimit, sipas librezës së punës marrëdhëniet financiare kanë filluar në datën 01.08.2009);
 9. *****, punësuar në pozicionin “Përgjegjës Finance”, në ish komunën Rrajcë (sotnjësi administrative), në Bashkinë Prrenjas, me aktin nr. 55, datë 18.07.2011;

10. *****, punësuar në pozicionin “*Specialisti pyjeve dhe kullotave*”, në ish komunën Rrajcë (sot njësi administrative), në Bashkinë Prrenjas, me aktin nr. 18, datë 20.03.2012;
11. *****, punësuar në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës së Ndhmës Ekonomike*”, në ish komunën Rrajcë (sot njësi administrative), në Bashkinë Prrenjas, me aktin nr. 18/1, datë 22.05.2007;

Njësia përgjegjëse, duhet t’iu njoftojë punonjësve të mësipërm, aktet individuale të deklarimit, me qëllim garantimin e të drejtave që lindin në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

3. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Prrenjas, në kuptim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, për punonjës *****, i cili aktualisht kryen funksionin e Nënkryetarit të Bashkisë, në cilësinë e funksionarit të kabinetit, duhet të finalizojë procesin e deklarimit të statusit të punësimit, duke nxjerrë aktin e deklarimit si “*Nëpunës civil*”, në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës së Taksave*”, në ish komunën Rrajcë (sot njësi administrative), në Bashkinë Prrenjas.

Në zbatim të nenit 54, pika 1, germa a), të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Prrenjas duhet të nxjerrë aktin e pezullimit nga shërbimi civil për nëpunësin *****, për periudhën e ushtrimit të detyrës së funksionarit politik.

4. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të Bashkisë Prrenjas, në rastin e punonjësve ***** dhe ***** , të cilët nuk i përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civilë, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të kryejë veprimet si më poshtë:

- ✓ Të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës, duke evidentuar faktin se punonjësi *****, emëruar në pozicionin “*Specialist urbanist*” dhe punonjësi *****, emëruar në pozicionin “*Specialist urbanist*”, nuk i përmbushin kriteret e veçanta dhe konkretisht kriterin arsimor, për të qenë nëpunës civilë, në zbatim të pikës 6, të vendimit 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”*”, i ndryshuar, pasi ata nuk zotërojnë diplomë të arsimit të lartë.

- ✓ Pozicionet e punës të shpallen të lira, për t’u plotësuar më tej në përputhje me ligjin për nëpunësin civil, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e institucionit.
5. Institucioni i Bashkisë Prrenjas, në rastin e punonjësve ***** dhe *****, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, që ka të bëjë me deklarin e statusit të punësimit në kundërshtim me nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duhet të kryejë veprimet si më poshtë:
- ✓ Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, në kuptim të nenit 108 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit të deklarin të statusit të punësimit për punonjësin *****, deklaruar me aktin nr. 81, datë 16.04.2014 dhe për punonjësin *****, deklaruar me aktin nr. 276/1, datë 22.04.2015, duke evidentuar faktin se akti i emërimit ka dalë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 22, 23, e në vijim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
 - ✓ Kryetari i Bashkisë Prrenjas, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit të emërimit për punonjësin *****, në pozicionin “Specialist i mbrojtjes së tokës”, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, Menaxhimit të Tokës dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të Bashkisë Prrenjas, emëruar me aktin nr. 395, datë 30.08.2017 dhe për punonjësin *****, në pozicionin “Veteriner”, në njësinë administrative Qukës, emëruar me aktin nr. 423, datë 18.10.2016, pasi emërimi i tyre në pozicionet e shërbimit civil është bërë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pa respektuar procedurën e konkurrimit të hapur nëpërmjet pranimit në shërbimin civil.
 - ✓ Pozicionet e punës të shpallen të lira, për t’u plotësuar më tej në përputhje me ligjin për nëpunësin civil, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e institucionit.
6. Kryetari i Bashkisë, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit dhe të rregullohen pasojat, duke ndërprerë marrëdhënien e punës dhe atë financiare me institucionin për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të cilët janë evidentuar në vijim sipas emrit, pozicionit të punës dhe aktit të emërimit, të nxjerra nga titullari i institucionit:

1. *****, “*Specialist IT*”, në Bashkinë Prrenjas, emëruar me urdhrin nr. 39, datë 26.02.2016.
2. *****, “*Specialist për prokurimet*”, në Sektorin Juridik dhe Burimeve Njerëzore, emëruar me urdhrin nr. 177, datë 20.04.2016.
3. *****, “*Specialist për burimet njerëzore*”, në Sektorin Juridik dhe Burimeve Njerëzore, emëruar me urdhrin nr. 310, datë 12.07.2016.
4. *****, “*Specialist për marrëdhënien me publikun*”, në Sektorin Juridik dhe Burimeve Njerëzore, emëruar me urdhrin nr. 423, datë 11.09.2017.
5. *****, “*Specialist/koordinator për të drejtën e informimit dhe ankesave*”, në Sektorin Juridik dhe Burimeve Njerëzore, emëruar me urdhrin nr. 421, datë 18.09.2017.
6. *****, “*Përgjegjës i Sektorit të Arsimit, Kulturës, Turizmit dhe Sportit*”, emëruar me urdhrin nr. 413, datë 05.09.2017.
7. *****, “*Specialist për turizmin*”, në Sektorin e Arsimit, Kulturës, Turizmit dhe Sportit, emëruar me urdhrin nr. 430, datë 20.10.2016.
8. *****, “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit Financiar, emëruar me urdhrin nr. 113, datë 18.08.2017.
9. *****, “*Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave*”, në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit Financiar, emëruar me urdhrin nr. 463, datë 21.09.2017.
10. *****, “*Inspektor për tregun*”, në Sektorin e Tatim Taksave, emëruar me urdhrin nr. 145, datë 08.04.2016.
11. *****, “*Inspektor- specialist për tregun*”, në Sektorin e Tatim Taksave, emëruar me urdhrin nr. 415, datë 07.09.2017.
12. *****, “*Topograf*”, në Drejtorinë e Urbanistikës dhe Hartimit të Politikave të BE, emëruar me urdhrin nr. 127, datë 23.03.2016.
13. *****, “*Inxhinier/arkitekt*”, në Drejtorinë e Urbanistikës dhe Hartimit të Politikave të BE, emëruar me urdhrin nr. 418, datë 12.10.2016.
14. *****, “*Inxhinier mjedisi dhe specialist projektues*”, në Drejtorinë e Urbanistikës dhe Hartimit të Politikave të BE, me urdhrin nr. 126, datë 21.03.2016.
15. *****, “*Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Social dhe Emergjencave Civile*”, emëruar me urdhrin nr. 448, datë 18.09.2017.
16. *****, “*Specialist i emergjencave civile*”, në Sektorin e Shërbimit Social dhe Emergjencave Civile, emëruar me urdhrin nr. 52, datë 03.03.2016.
17. *****, “*Specialist i emergjencave civile*”, në Sektorin e Shërbimit Social dhe Emergjencave Civile, me urdhrin nr. 425, datë 11.09.2017.
18. *****, “*Specialist për problemet e dhunës në familje dhe barazisë gjinore*”, në Sektorin e Shërbimit Social dhe Emergjencave Civile, emëruar me urdhrin nr.65, datë 03.03.2016.

19. *****, “*Specialist për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*”, në Sektorin e Shërbimit Social dhe Emergjencave Civile, emëruar me urdhrin nr. 273, datë 21.06.2017.
20. *****, “*Punonjës social*”, në Sektorin e Shërbimit Social dhe Emergjencave Civile. (*Mungon akti i emërimit, kalimi në këtë pozicion është bërë më miratimin e strukturës së Shtator 2017*);
21. *****, “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, Menaxhimit të Tokës dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, emëruar me urdhrin nr. 404, datë 05.10.2016.
22. *****, “*Inspektor për mbrojtjen e konsumatorit*”, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, Menaxhimit të Tokës dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, emëruar me urdhrin nr. 218, datë 17.05.2016.
23. *****, “*Inspektor teknolog*”, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, Menaxhimit të Tokës dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, emëruar me urdhrin nr. 90, datë 11.03.2016.
24. *****, “*Inspektor për konfliktet mbi tokën*”, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, Menaxhimit të Tokës dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, (*Mungon akti i emërimit, kalimi në këtë pozicion është bërë me miratimin e strukturës Shtator 2017*).
25. *****, “*Përgjegjës Shërbimesh*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 52, datë 10.02.2017.
26. *****, “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Transportit dhe Mirëmbajtjes së Rrugëve, emëruar me urdhrin nr. 46, datë 03.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
27. *****, “*Inspektor i rrugëve rurale*”, në Drejtorinë e Transportit dhe Mirëmbajtjes së Rrugëve, emëruar me urdhrin nr. 107, datë 17.03.2016.
28. *****, “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, emëruar me urdhrin nr. 86, datë 27.02.2017.
29. *****, “*Specialist pyjesh*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, emëruar me urdhrin nr. 87, datë 27.02.2017.
30. *****, “*Specialist administrim menaxhim*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, emëruar me urdhrin nr. 26, datë 18.01.2017.
31. *****, “*Inspektor pyjesh*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, emëruar me urdhrin nr. 106, datë 17.03.2016.
32. *****, “*Inspektor i Mbrojtjes së Pyjeve*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, emëruar me urdhrin nr. 339, datë 27.07.2016.
33. *****, “*Inspektor zone pyjore*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, emëruar me urdhrin nr. 75, datë 17.02.2017.
34. *****, “*Inspektor zone pyjore*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, emëruar me urdhrin nr. 80, datë 21.02.2017.
35. *****, “*Inspektor zone pyjore*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, emëruar me urdhrin nr. 450, datë 07.11.2016.
36. *****, “*Inxhinieri mjedisi*”, në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, emëruar me urdhrin nr. 447, datë 18.09.2017.

37. *****, “*Specialist i ndihmës ekonomike*”, në njësinë administrative Rrajcë, emëruar me urdhrin nr. 209, datë 10.05.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
38. *****, “*Specialist i mbrojtjes dhe menaxhimit të tokës*”, në njësinë administrative Rrajcë emëruar me urdhrin nr. 118, datë 21.03.2016.
39. *****, “*Arkëtar arkivist dhe protokolliste*”, në njësinë administrative Rrajcë, emëruar me urdhrin nr. 19, datë 24.03.2009,
40. *****, “*Veteriner*”, në njësinë administrative Rrajcë, emëruar me urdhrin nr. 270, datë 20.06.2016.
41. *****, “*Specialist i ndihmës ekonomike*”, në njësinë administrative Qukës, emëruar me urdhrin nr. 239, datë 30.05.2016.
42. *****, “*Specialist i ndihmës ekonomike*”, në njësinë administrative Qukës, emëruar me urdhrin nr. 79, datë 20.02.2017.
43. *****, “*Specialist i ndihmës ekonomike*”, në njësinë administrative, Stavraj, emëruar me urdhrin nr. 47, datë 11.08.2015.
44. *****, “*Specialist i mbrojtjes dhe menaxhimit të tokës*”, në njësinë administrative Stavraj, emëruar me urdhrin nr. 394, datë 30.08.2017.
45. *****, “*Veteriner*”, në njësinë administrative Stavraj, emëruar me urdhrin nr. 411, datë 05.09.2017.

- ✓ Njësia përgjegjëse, të planifikojë ecurinë e kësaj procedure, me qëllim që konstatimi si akte absolutisht të pavlefshëm prej Kryetarit të Bashkisë, të kryhet në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe sipas orientimeve në raportin e mbikëqyrjes.
- ✓ Dokumenti i planit të veprimit në këtë rast do të paraqitet për miratim Komisionerit, brenda afatit të paralajmërimit dhe më tej do të ndiqet zbatimi i tij nga Sekretariati i Komisionerit, sipas afateve të vendosura në këtë akt.

7. Njësia përgjegjëse para se të fillojë procesin e konkurrimeve për të plotësuar vendet vakante, të hartoj menjëherë planin vjetor të pranimit në shërbimin civil dhe ta dërgojë për miratim Kryetarit të Bashkisë dhe në të ardhmen ky proces duhet të ketë përfunduar brenda muajit shkurt të çdo viti kalendarik. Njësia përgjegjëse duhet të kujdeset që plani vjetor i nevojave për rekrutim në shërbimin civil, të bëhet publik në faqen zyrtare të “*Shërbimit Kombëtar të Punësimit*”, në faqen zyrtare të internetit dhe në stendat për informimin e publikut, në mënyrë që konkurrimet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të përmbajnë të gjitha të dhënat e kërkuara nga përcaktimet e nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*”, të tillë si: numri i vendeve vakante për të cilat duhet të shpallet konkurrimi për çdo kategori dhe klasë; rastet

përrjashtimore nëse do të pranohen dhe kandidatë të tjerë për të aplikuar në procedurat e ngritjes në detyrë, si dhe kërkesa të tjera ligjore.

8. Kryetari i Bashkisë, në zbatim të nenit 111, të Kodit të Procedurës Administrative, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolutë të akteve të emërimit, si akte të nxjerranë kundërshtim me nenin 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të vendosë ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe financiare, për nëpunësit:

- ***** , punësuar në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës dhe Hartimit të Politikave të BE”, në Bashkinë Prrenjas, emëruar me aktin nr. 242, datë 01.06.2016.
- ***** , punësuar në pozicionin “Përgjegjës për projektet me BE”, në Drejtorinë e Urbanistikës dhe Hartimit të Politikave të BE, në Bashkinë Prrenjas, emëruar me aktin nr. 85, datë 11.03.2016.
- ***** , punësuar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit”, në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit Financiar (*Mungon akti i emërimit në këtë pozicion, por kalimi është bërë me miratimin e strukturës në Shtator 2017*).

✓ Njësia përgjegjëse, duhet të trajtojë nëpunësit ***** , ***** dhe ***** , sipas kategorisë së pozicionit të punës, në të cilën ata gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

✓ Pozicionet e punës të shpallen të lira, për t’u plotësuar më tej në përputhje me ligjin për nëpunësin civil, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e institucionit.

9. Kryetari i Bashkisë, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolutë të aktit të emërimit për punonjësin ***** , në pozicionin “Topograf”, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, Menaxhimit të Tokës dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në Bashkinë Prrenjas, emëruar me aktin nr. 65, datë 13.02.2017 dhe të rregullojë pasojat, duke ndërprerë marrëdhëniet financiare me institucionin, si punonjës i emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Pozicioni i punës, pas ekuivalentimit si pozicion i shërbimit civil, të pajiset me përshkrim pune dhe të shpallet i lirë, për t’u plotësuar më tej në përputhje me ligjin për nëpunësin civil, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e institucionit.

10. Me qëllim realizimin e një strukturë administrative të qëndrueshme, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe në kuadrin e detyrimeve ligjore të përcaktuara në ligjin për

vetëqeverisjen vendore, për të hartuar strukturën përfundimtare të bashkisë për vitin 2018, njësia përgjegjëse e institucionit duhet të veprojë duke ndjekur këto orientime:

- ✓ Gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucionit për vitin në vijim, të zbatohet skema e funksionimit të shërbimit civil, në përputhje me nenin 19, të ligjit për nëpunësin civil, si dhe aktet nënligjore që rregullojnë aspekte të veçanta për të gjitha institutet e tij, duke u orientuar në përmbajtjen e raportit.
- ✓ Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në strukturën pasardhëse të institucionit duhet të përcaktojë pozicionet e shërbimit civil, duke i ndarë nga pozicionet që do të kryejnë funksione politike dhe nga pozicionet që nuk ushtrojnë funksion publik (*punonjësit administrativ*) dhe t'i përshtasë detyrat dhe funksionet e pozicioneve të shërbimit civil, në përputhje me kërkesat e vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, si dhe me ligjet që rregullojnë çdo sektorë të veprimtarisë së bashkisë.
- ✓ Për pozicionet e punës me emërtesën *“Topograf”, “Inxhinier/arkitekt”, “Punonjës Social”, “Ekonomist”, “Inxhinier mjedisi”, “Inxhinier pyjesh”, “Veteriner”* dhe *“Arkëtare dhe arkiv protokollit”*, njësia përgjegjëse të saktësojë emërtesat e pozicioneve të punës, të përcaktojë qartë detyrat teknike dhe përgjegjësitë që realizon secili pozicion pune dhe për rastet e vlerësuara në kategorinë e nëpunësit civil, të hartohen formularët e përshkrimit të punës dhe të zbatohen kërkesat ligjore për plotësimin e tyre.
- ✓ Njësia e auditimit të brendshëm, të organizohet në përputhje me kërkesat e ligjit nr.114/2015, *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*, të ndryshuar; të vendimit nr. 83, datë 03.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”*, si dhe të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, më qëllim që të evidentohen pozicionet e shërbimit civil sipas kategorisë, klasës dhe kategorisë së pagës.
- ✓ Njësia përgjegjëse e institucionit të Bashkisë Prrenjës, duhet të përfundojë procesin e hartimit të rregullores së brendshme të institucionit, me qëllim që të pasqyrohen qartë detyrat për çdo pozicion pune, si dhe ndryshimet ligjore dhe strukturore të institucionit.

11. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Vendimin nr. 142,

datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", të ndryshuar dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkuara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe të mbahen parasysh gjatë procesit të miratimit të strukturës përfundimtare të institucionit gjatë vitit 2018, për të zbatuar detyrimin ligjor të respektimit të skemës së funksionimit të shërbimit civil, parashikuar në nenin 19, të ligjit për nëpunësin civil. Një kopje e përshkrimeve të punës, të depozitohet në arkivin e institucionit.

Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të njohë të gjithë aktorët e procesit të hartimit të përshkrimeve të punës me vendimin e Komisionerit.

- 12.** Njësia përgjegjëse e Bashkisë Prrenjas, pas miratimit të strukturës përfundimtare gjatë vitit 2018, duhet të respektojë kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë", si dhe orientimeve të raportit të mbikëqyrjes, me qëllim rregullimin e marrëdhënies së punësimit për nëpunësit ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** dhe ***** , të cilët aktualisht nuk janë ripozicionuar sipas strukturës aktuale të institucionit.

Njësia përgjegjëse e Bashkisë Prrenjas dhe Komisioni i Ristrukturimit, duhet të sistemojnë nëpunësit e mësipërm nëpërmjet transferimit të përhershëm në kuadër të rristrukturimit të institucionit, duke marrë në konsideratë kategorinë dhe klasën e pozicionit të punës, në të cilën këta punonjës kanë përfituar statusin e nëpunësit civil në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit për shërbimin civil dhe duke i krahasuar me pozicionet e strukturës që do të aplikohet.

- 13.** Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, duhet të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2017 dhe në vijim, për vitin 2018, të ndjekë procesin për të respektuar afatet, duke orientuar edhe aktorët e tjerë të procesit, në rolin e zyrtarit raportues, zyrtarit kundërfirmues dhe zyrtarit autorizues, sipas orientimeve të dhëna në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Njësia përgjegjëse të njohë të gjithë aktorët e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë me vendimin e Komisionerit.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, të përfshihet në Regjistrin Qendror të Personelit, formulari i vlerësimit për çdo nëpunës civil.

- 14.** Njësia e burimeve njerëzore të institucionit të sistemojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 dhe 2, pjesë e vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”, dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të Raportit përfundimtar të Mbikëqyrjes.
- 15.** Për kryerjen e këtyre veprime administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
- 16.** Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Prrenjas, duhet të njoftojë me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
- 17.** Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjositjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
- 18.** Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Prrenjas, duke i kërkuar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha